



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN

Nr. 1346/9 Prot.

Tiranë, më 18.9. 2020

VENDIM

Nr. 5, datë 16.09.2020

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR, PËR PRODHIM
HIDROENERGJIE HEC HEKALI, NJËSIA ADMINISTRATIVE IBË, BASHKIA
TIRANË, PËR SUBJEKTIN "AGE ERZEN" SHPK

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 12, neni 41, pikës 2 të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, V.K.M –së Nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre” dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat, Këshilli i Basenit Ujor Erzen.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidroenergjie,“Hec Hekali” subjektit “AGE ERZEN” shpk sipas kufizimeve të mëposhtme :
 - Përdorimi i ujit për prodhim hidroenergjie do të jetë në periudhën Tetor – Prill, ndërsa periudha Maj – Shtator do të jetë në dispozicion për qëllime ujitje sipas nevojave të hartuara nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendor dhe atij Qendror.
 - Të respektoj grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës kur e kërkon Bordi i Kullimit .
 - Të respektojë rrjedhjen ekologjike.
 - E gjithë infrastruktura ujitëse (kanali ujitës,diga, baseni i presionit, portat e komandimit) të mirëmbahen nga subjekti dhe të jenë në gadishmëri të plotë për fillimin e sezonit të vaditjes.
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujqor Ishëm – Erzen – Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Anastasi Meci



KRYETAR

Suzana Jahollari

